



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Sigurria Juridike e Pronës

Mbledhje e Këshillit të Investimeve
20 prill 2026

01

Objekti dhe Metodologjia

Hulumtime & Analiza, Konsultime,
Pyetesor

02

Konteksti dhe Rëndësia

Pse siguria juridike e pronës është parakusht
thelbësor për zhvillimin ekonomik

03

Gjetjet Kryesore

Analiza e gjetjeve nga këndvështrimi i biznesit
për 12 fusha kyçe

04

Rekomandime

Propozime për përmirësimin e sigurisë juridike
të pronës dhe klimës së investimeve

Përse kjo Problematikë? Rëndësia....



Rritja Ekonomike

Sigurimi i të drejtave të pronësisë dhe zbatimi korrekt i tyre konsiderohet **parakusht thelbësor** për rritjen ekonomike të vendit.



Stimulimi i Investimeve

Reforma e regjistrimit të tokës është një nga **shtyllat kryesore** të zhvillimit të Shqipërisë dhe pjesë e Agjendës së Rritjes.



Aksesi në Kredi

Prona e regjistruar me titull të qartë lehtëson aksesin në financim dhe përdorimin e pronës si kolateral për kredi biznesi.

OBJEKTI I ANALIZËS

Vlerësimi i progresit, sfidave praktike të **procesit të digjitalizimit dhe administrimit kadastral** si edhe ndikimin e tyre në sigurinë juridike të pronës dhe klimën e investimeve nga këndvështrimi i biznesit me fokus:

**Akresi në të dhënat
kadastrale**

**Saktësia e regjistrimit
të pronës**

**Efikasiteti i
procedurave dhe
shërbimeve**

**Ndikimi në investime
/ transaksione**

METODOLOGJIA

Hulumtime & Analiza

- Raporte kombëtare dhe ndërkombëtare, ligje/akte nënligjore
- Analiza të të dhënave zyrtare nga burimet dytësore
- Sintezë e gjetjeve dhe rekomandimeve të deritanishme të KI
- Puna e Sekretariatit mbi problematikat e pronës
- Analiza e problematikave nga bizneset dhe shoqatat (2015-2025)

Konsultime

- Konsultime me ASHK, AMVV, AMCHAM, NAREA, BE, UNOPS etj.
- Takim me 21 pjesëmarrës nga shoqata biznesi (7 prill 2025)
- Përfshirje e AIDA, Noterisë, FIAA, Agroturizimit dhe Kryenegociatorit

Pyetësor

- Pyetësor online me Noterinë, NAREA, Dhomën e Tregtisë dhe Gruas
- Fokusi: Sfidat ndaj transformimit digjital të shërbimeve
- **146 përgjigje anonime**

PROBLEMATIKA TË REFERUARA NGA BIZNESI

KADASTRA DIGJITALE

Nuk është ende realitet. Mungon aksesimi për të verifikuar statusin juridik të pronave shtetërore dhe të tjerave.

PASAKTËSI TË DHËNASH

Pasaktësi në kopje kartelesh, harta treguese etj., në raport me situatën faktike në raste të caktuara.

KOMPENSIMI

Pamundësi për të kërkuar kompensim për shërbime kadastrale të kryera me gabime.

UNIFIKIMI

Praktika të paunifikuara në proceset e punës dhe trajtime preferenciale.

KOSTOT

Kosto e diskutueshme e shërbimeve

TARIFAT KADASTRALE

Nuk ka metodologji të publikuar

RI-APLIKIMET

Nevoja për ri-aplikime të përsëritura për të njëjtat çështje/problematika.

VLERA E PRONËS

Certifikata e pronësisë nuk përmban të shënuar vlerën e pasurisë.

E-ALBANIA

Probleme me funksionimin dhe strukturimin e shërbimeve që kërkojnë nivel ekspertize.

AFATET

Regjistrimi, hipotekimi dhe transferimi i pronës kryhet jashtë afateve ligjore.

LLOGARIDHËNIA

Mungesë llogaridhënieje institucionale në ofrimin e shërbimeve.

VULA DIGJITALE

Aktet vetëm me vulë digjitale krijojnë vështirësi për transaksionet bankare.

KONTEKSTI

Konteksti politik dhe institucional

- thekson rëndësinë e të drejtave të sigurta dhe transparente të pronës në zhvillimin ekonomik dhe integrimin evropian.

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030

Programi i Reformave Ekonomike 2025–2027

- priorizojnë nevojën për përfundimin e regjistrimit fillestar të pronave, avancimin e digjitalizimit të plotë të sistemeve kadastrale
- përmirësimin e saktësisë së të dhënave, me qëllim forcimin e sigurisë juridike, uljen e kostove të transaksioneve dhe mbështetjen e investimeve

Raporti i Progresit i BE-së 2025

Deklarata për Klimën e Investimeve 2025 e Departamentit të Shtetit të SHBA-së

- theksojnë sfida të vazhdueshme, përfshirë rreziqet e korrupsionit, regjistrimin e paplotë dhe të paqëndrueshëm
- dokumentacionin e vjetëruar dhe zbatimin e dobët të të drejtave të pronësisë

REFORMA SI PJESË E AGJENDËS SË RRITJES

NIVELI STRATEGJIK: Konsolidimi institucional dhe digjitalizimi e përsheptuar

NIVELI OPERACIONAL

Transformimi Digjital

Nga 2020, të gjitha shërbimet kadastrale janë të disponueshme online përmes platformës **e-Albania**.

Cilësia e të Dhënave

Qendra e Kadastrës Digjitale (viti 2022) e përqendruar në digjitalizimin dhe përmirësimin e saktësisë së të dhënave.

Modernizimi i Shërbimit

- Shërbimi "**Fast Track**" për shpejtësi.
- Teknologjia **Blockchain** për 10 shërbime kryesore.
- Mundësi pagese online për efikasitet të plotë.

KUADRI LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

SIGURIA E PRONËSISË

Të drejtat e qarta si garanci

Ligj Nr. 111/2018 “Për Kadastrën” dhe Ligj Nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare” (Afati: 31 Dhjetor 2028)

Reforma Institucionale

Krijimi i ASHK si agjenci e centralizuar për një sistem të unifikuar, duke synuar efikasitet dhe digjitalizim.

Statusi Aktual

Zbatimi ende përballet me vonesa dhe pasiguri praktike në terren.

DIGJITALIZIMI

Regjistrimi dhe Modernizimi

Ligji 20/2020 synon një sistem të plotë dhe të sigurt me progres të dukshëm në digjitalizimin e pasurive.

Pritshmëritë e Biznesit

Analizë e arritjeve kundrejt pritshmërive nga këndvështrimi i sektorit privat.

Sfida Kryesore

Zona të paregjistruara dhe vonesa në përfundimin e proceseve tranzitore.

REFORMAT NDËRLIDHËSE

Paketa e Maleve


Nxitja e zhvillimit ekonomik malor përmes legalizimit të thjeshtuar dhe lehtësirave fiskale.

Kadastra Fiskale

Sistem digjital për taksimin e pronave bazuar në vlerën e tregut (në zhvillim e sipër).

Konvergjencia

Ndërthurja e regjistrimit të pronës me reformat e tjera strategjike të vendit.



2. GJETJE


GJETJE 1: ZGJERIMI I AKSESIT

Biznesi shpreh nevojën për akses më të madh në të dhënat kadastrale, duke kërkuar transparencë të plotë dhe informacion të hapur për përdorim ekonomik.


Kërkohet zgjerimi në një gamë më të gjerë **sektorësh profesionalë** për shërbime më të shpejta dhe efektive.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – ZGJERIMI I AKSESIT

A mendoni se përveç noterëve, edhe palë të tjera mund të kenë akses në database te ASHK per të verifikuar paraprakisht ne statusin e pronës tuaj (me konsensusin tuaj):



A mendoni se përveç noterëve, edhe palë të tjera mund të kenë akses në database te ASHK per të verifikuar paraprakisht ne statusin e pronës tuaj (me konsensusin tuaj)?



GJETJE 2: NEVOJA PËR PROCEDURA MË TË STANDARTIZUAR

Problematikat e Raportuara

RI-APLIKIME DHE PAGESA TË PËRSËRITURA

Shumica e kompanive deklarojnë se pagesat e përsëritura lidhen me problematika nga ASHK-ja dhe mungesën e informacionit të qartë publik.

KËRKESA PËR DOKUMENTACION SHITESË

Shumica e kompanive deklarojnë se pagesat e përsëritura lidhen me problematika nga ASHK-ja dhe mungesën e informacionit të qartë publik.

Burimi i Problematikave

Digjitalizimi, Regjistrimi dhe Saktësia e të Dhënave

Mungesa e regjistrimit në gjithë territorin, dixhitalizimi i papërfunduar dhe saktësia e të dhënave kadastrale sjellin trajtim jo-uniform të praktikave.


Mungesa e të Dhënave Historike

Nevojitet dokumentacion shtesë në raste aplikimesh komplekse për shkak të mungesës së të dhënave historike në arkivën e ASHK-së.


GJETJE 2: NEVOJA PËR PROCEDURA MË TË STANDARTIZUAR (vazhdim)

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – PAGESAT E PËRSËRITURA


A keni paguar tarifa më shumë se 1 herë për të njëjtin shërbim?



A keni paguar tarifa më shumë se 1 herë për të njëjtin shërbim?




Nëse po, kjo për arsye të?




GJETJE 2: NEVOJA PËR PROCEDURA MË TË STANDARTIZUAR (vazhdim)

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – DOKUMENTACIONI SHITESË

A kërkohet dokumentacion shtesë ndryshe nga ato të publikuara dhe të kërkuara në momentin e aplikimit fillestar?



A kërkohet dokumentacion shtesë ndryshe nga ato të publikuara dhe të kërkuara në momentin e aplikimit fillestar?



GJETJE 3: MONITORIMI I PERFORMANCËS (AFATEVE)

Perceptimi i Vonesave


Ndonëse ka afate të publikuara, subjektet perceptojnë vonesa në ofrimin e shërbimeve. Nevojitet përmirësim i shpejtësisë për aplikimet përmes e-Albania dhe noterëve.

Kërkesë për Monitorim


Një kuadër i formalizuar monitorimi do të siguronte përpunim cilësor dhe respektim të afateve, edhe për aplikimet komplekse.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – PERFORMANCA

A përftohen shërbimet brenda afatit të parashikuar?



A përftohen shërbimet brenda afatit të parashikuar?



GJETJE 4: TARIFIMI KUNDREJT CILËSISË

Cilësia vs. Tarifat


Pothuajse një në dy kompani e vlerëson cilësinë si të pamjaftueshme në raport me tarifën. Nevojitet një strukturë më e qartë për të rritur transparencën.

Qëndrimet mbi Tarifat


Evidentohen mendime të ndryshme: disa palë i konsiderojnë tarifën si të larta, ndërsa të tjera i shohin ato si të arsyeshme.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – TARIFA vs. CILËSI

Mendoni se cilësia e shërbimit justifikon tarifën që paguani?



Mendoni se cilësia e shërbimit justifikon tarifën që paguani?



GJETJE 5: PËRMIRËSIMI I QASJES NË INFORMACION

Mbështetja te Noterët


Subjektet tregojnë një mbështetje të fortë te noterët për informacion mbi dokumentacionin, tarifrat dhe afatet e shërbimeve kadastrale.

Nevoja për Përmirësim


Kanalet zyrtare janë të disponueshme, POR ekziston nevoja për të përmirësuar qartësinë, aksesueshmërinë dhe përmbajtjen e informacionit zyrtar të ASHK-së.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – QASJA NË INFORMACION

Ku drejtoheni kur duhet të merrni informacion mbi dokumentacionin e kërkuar, tarifrat dhe afatet e shërbimeve kadastrale, përgjithësisht:



Përdorimi i shërbimeve të ASHK



GJETJE 6: SISTEMI I REAGIMEVE DHE ANKESAVE

Njohja e Mekanizmit


Në përgjithësi, mekanizmi i ankesave të ASHK-së njihet nga bizneset, por perceptohet si joefektiv nga ata që kanë pasur përvojë në përdorimin e tij.

Kënaqësia e Ulët


Diskutimet me ekspertë konfirmuan ndërgjegjësimin, POR evidentuan një nivel të ulët kënaqësie në lidhje me përgjigjet dhe zgjidhjet e ofruara.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – SISTEMI I ANKESAVE

Nëse keni pasur ndonjë problem apo vonesë a e keni përdorur ndonjëherë mekanizmin e ankesave të ASHK-së?



Nëse keni pasur ndonjë problem apo vonesë a e keni përdorur ndonjëherë mekanizmin e ankesave të ASHK-së?



GJETJE 7: NDIKIMI I DIGJITALIZIMIT NË EFIKASITETIN E SHËRBIMEVE

Efikasiteti dhe Administrimi

Digjitalizimi perceptohet gjerësisht si një faktor që përmirëson efikasitetin dhe redukton barrën administrative.

Integriteti dhe Korrupsioni


Ndikimi në uljen e korrupsionit mbetet i kufizuar. ASHK-ja duhet të zbatojë me rigorozitet Planin e Integritetit.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – EFIKASITETI

Në opinionin tuaj, marrja e shërbimeve të ASHK në mënyrë elektronike (të digjitalizuar), a ka ndihmuar në reduktimin e praktikave korruptive për shkak të mungesës së kontaktit fizik me punonjësit?

Në opinionin tuaj, marrja e shërbimeve të ASHK në mënyrë elektronike (të digjitalizuar), a ka ndihmuar në reduktimin e barrës administrative (kohën e harxhuar, kostot financiare, etj. për të përfituar shërbimet)?

A mendoni se është lehtësuar përftimi i shërbimeve të ASHK me kalimin e tyre online?




GJETJE 8: LEHTËSIA E PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE ONLINE


Profesionistët i perceptojnë procedurat si të thjeshta, ndërsa një pjesë e konsiderueshme e bizneseve hasin vështirësi, duke evidentuar nevojën për qartësi më të madhe dhe udhëzime më të përmirësuara për të garantuar aksesueshmëri për të gjithë përdoruesit.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – PËRDORIMI I SHËRBIMEVE ONLINE

Vlerësoni lehtësinë e përdorimit të shërbimeve online mbi pronën



Vlerësoni lehtësinë e përdorimit të shërbimeve online mbi pronën




GJETJE 9: NDIKIMI TEK INVESTIMET


Proceset e paplota të regjistrimit të pronës, si dhe pasaktësitë në dokumentacionin e pronës, përbëjnë një pengesë të rëndësishme për investimet, duke ndikuar drejtpërdrejt në klimën e biznesit dhe zhvillimin ekonomik.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – NDIKIMI I SHËRBIMEVE NË INVESTIME

A ka pasur vonesa apo mosrealizim të planeve të investimit për shkak të proceseve të regjistrimit apo pasaktësisë së dokumentacionit të tokës/pronës?



A ka pasur vonesa apo mosrealizim të planeve të investimit për shkak të proceseve të regjistrimit apo pasaktësisë së dokumentacionit të tokës/pronës?




GJETJE 10: KOORDINIMI INSTITUCIONAL


Koordinimi institucional (ndërveprimi bashki, tatime etj) mbetet një fushë ku një pjesë e konsiderueshme e bizneseve përballen me sfida, duke evidentuar nevojën për përmirësim të harmonizimit dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – KOORDINIMI INSTITUCIONAL

A keni pasur vonesa apo problematika për shkak të kordinimit të dobët midis ASHK dhe institucioneve të tjera shtetërore (Bashkisë, Tatime, etj)



A keni pasur vonesa apo problematika për shkak të kordinimit të dobët midis ASHK dhe institucioneve të tjera shtetërore (Bashkisë, Tatime, etj)



GJETJE 11: DISA SHËRBIMEVE PERCEPTOHEN MË PROBLEMATIKE

Shërbimet që perceptohen më shpesh si problematike përfshijnë regjistrimin përfundimtar të ndërtimeve të reja, regjistrimin e bashkimeve ose ndarjeve të pronave, si dhe verifikimin online të statusit ligjor të pronësisë.

PERCEPTIMI I BIZNESEVE – SHËRBIMET PROBLEMATIKE

Shërbime më problematike (Vlerësim sipas frekuencës)





3. REKOMANDIME

3.1 REKOMANDIME - STANDARTIZIMI

Rekomandimi 1: Standardizimi i Procedurave dhe Dokumentacionit

(a) Manuale dhe Lista Kontrolli

Të hartohen dhe publikohen manuale operacionale të unifikuara e të detyrueshme për shërbimet kadastrale.

- Lista kontrolluese (checklists) gjithëpërfshirëse.
- Zbatim i njëlojtë në të gjitha zyrat rajonale.

(b) Unifikimi i Terminologjisë

Të unifikohet terminologjia për përgjigjet zyrtare nga zyrat e kadastrës.

Përfitimet Kryesore:

- Minimizimi i pasigurisë procedurale.
- Ulja e kostove administrative.
- Përsheptimi i ofrimit të shërbimeve.

3.2 REKOMANDIME – AKSESI

Rekomandimi 2: Vlerësimi i fizibilitetit për një akses më të gjerë në Kadastrën Digjitale

Akses i Drejtpërdrejtë

Të bëhet një vlerësim mbi mundësinë e dhënies së aksesit të drejtpërdrejtë në kadastrën digjitale disa “përdoruesve profesionistë të përzgjedhur”.

Qëllimi:

- Lehtësimi i procesit të kontrollit (due diligence).
- Verifikimi i kolateraleve.

Shtyllat Kryesore të Vlerësimit

Rekomandohet që vlerësimi të përqendrohet në tre shtylla kryesore:

- **Statusi i të dhënave:** Sigurimi që të dhënat kadastrale ofrojnë siguri dhe besueshmëri.
- **Dispozitat ligjore:** Rregullimi i mbrojtjes së të dhënave personale.
- **Siguria teknike:** Siguria e të dhënave dhe e sistemeve.

3.3 REKOMANDIME – TRANSPARENCA

Rekomandimi 3: Transparenca e Tarifave të Shërbimit

Publikimi i Metodologjisë

Të rritet transparenca lidhur me strukturën e tarifave, duke publikuar një metodologji të qartë.

Veprimi:

- Publikimi i parimeve shpjeguese të procesit.

Përcaktimi i Tarifave Kadastrale

Fokusi është në shpjegimin e detajuar të procesit se si përcaktohen tarifat.

Objektivi:

- Rritja e besueshmërisë institucionale përmes llogaridhënies publike mbi kostot e shërbimit.

3.4 REKOMANDIME – KOMUNIKIMI

Rekomandimi 4: Përmirësimi i Kanaleve Zyrtare të Komunikimit

Përmirësimi i Informacionit

Të përmirësohet qartësia, aksesimi dhe përmbajtja e informacionit zyrtar të ASHK-së.

Platformat kryesore:

- Platforma e-Albania
- Faqja zyrtare e ASHK-së

Strategjia e Komunikimit

Shfrytëzimi i Strategjisë së re për publikim proaktiv të informacionit të unifikuar.

Objektivat:

- Informacion mbi tarifën, afatet dhe dokumentacionin
- Ulja e varësisë së bizneseve nga ndërmjetësit

3.5 REKOMANDIME – VLERËSIMI I PERFORMANCËS

Rekomandimi 5: Zbatimi i Planit të Integritetit dhe Masave të Llogaridhënies

Plani i Integritetit

Të zbatohet në mënyrë rigoroze dhe efektive Plani i Integritetit i miratuar së fundmi nga ASHK-ja.

Qëllimi kryesor:

- Forcimi i masave kundër korrupsionit
- Sigurimi i zbatimit efektiv në nivel institucional

Metodologjia e Vlerësimit

Hartimi i një metodologjie të unifikuar dhe të standardizuar për vlerësimin e performancës së stafit.

Fokusi:

- Lidhja e arritjeve individuale me objektivat (afatet, cilësia)
- Integrimi i standardeve të integritetit në performancë

3.6 REKOMANDIME - GJITHËPËRFSHIRJA

Rekomandimi 6: Përfshirja e bizneseve në Monitorimin e Reformës

Përfshirja e Sektorit Privat

Të formalizohet përfshirja e përfaqësuesve të sektorit privat në strukturën institucionale për qeverisjen e reformës së pronës.

Elementet Kyçe:

- Përfshirja e shoqatave të biznesit dhe ekspertëve.
- Integrimi në Komitetin Ndërministror ose grupet teknike të punës.
- Përputhja e reformës me shqetësimet reale të palëve të interesuara.

3.7 REKOMANDIME – SISTEMI I ANKIMIMIT

Rekomandimi 7: Forcimi i Mekanizmave të Ankesave dhe Trajtimit të Pakënaqësive

Platforma e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit

Të krijohet një mekanizëm praktik dhe një platformë ndërvepruese për të mbikëqyrur kërkesat dhe për të menaxhuar ankesat.

Objektivat Kryesore:

- Garantimi i përgjigjeve substanciale ndaj ankesave.
- Sigurimi i trajtimit të ankesave në kohë.
- Monitorimi i respektimit të afateve të përcaktuara me ligj.

3.8 REKOMANDIME – REGJISTRIMI I PRONËS SHTETËRORE

Rekomandimi 8: Koordinim Aktiv mbi Regjistrimin e Pronave Publike dhe Shtetërore

Masat për Forcimin e Procesit të Regjistrimit

Për të siguruar një proces efikas dhe transparent të regjistrimit të pronave publike dhe shtetërore, propozohen ndërhyrjet e mëposhtme:

- Ngritja e **grupeve të punës ad hoc** të dedikuara dhe alokimi i zërave specifike buxhetorë.
- Kërkimi i **raportimit të strukturuar** dhe periodik mbi ecurinë e regjistrimit.
- Forcimi i **koordinimit ndërinstytucional** për të tejkaluar pasivitetin e bashkive.
- Ndërveprimi me shoqatat e biznesit (p.sh. agroturizmin) për prioritizimin sipas interesit të zhvillimit dhe vendndodhjes.

3.9 REKOMANDIME – SIGURIA LIGJORE

Rekomandimi 9: Forcimi i Sigurisë Ligjore të të Dhënave Kadastrale

Masat për Saktësinë e të Dhënave dhe Korrigjimin e Regjistrave

- Nxjerrja e një **udhëzimi të brendshëm të detyrueshëm** nga ASHK-ja për regjistrimin me saktësi të vlerës së pronës në të gjitha kartelat.
- Zbatimi i një **sistemi kontrolli në kadastrën digjitale** për të parandaluar lëshimin e kartelave me fushën “vlera e pronës” bosh ose “0”.
- Vlerësimi i shkallës së problemit dhe planifikimi i një **nisme për korrigjimin e të dhënave** në regjistrat ekzistues.
- Përdorimi i **të dhënave të verifikuara** të transaksioneve ose metodologjive zyrtare të vlerësimit gjatë përditësimit.

3.10 REKOMANDIME

Rekomandimi 10: Metodologjia për Çmimet e Referencës së Tokës Bujqësore

Objektivat e Metodologjisë së Re

Të hartohet një metodologji e re me qëllim që çmimet e referencës të pasqyrojnë më mirë realitetin e tregut:

- Adresimi i **diferencave të konsiderueshme** midis çmimeve administrative dhe çmimeve reale të transaksioneve.
- Sigurimi që vlerësimi i tokës bujqësore të bazohet në **të dhëna reale të tregut**.
- Përmirësimi i transparencës dhe saktësisë në proceset e vlerësimit të pronës.

FALEMINDERIT!

www.investment.com.al

Këshilli Investimeve mbështet nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI), Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Sekretariati Shtetëror Zviceran për Çështjet Ekonomike (SECO).